



MISIONI SHQIPTAR

E Lumja Nënë Tereza

Blessed Mother Teresa Albanian Mission
739 Browns Line, Etobicoke, Ontario M8W 3V7
Tel. 416 503 4509 dhe 647 558 9382
www.misioninenetereza.com

Çdo të dielë në orën 12:30 Rruzarja dhe Mesha Shenjte

I besuan Shkrimit Shenjt

8 Mars 2015



Ishin afër Pashkët e hebrenjve e Jezusi u ngjit në Jerusalem. Në Tempull gjeti shitës qesh, delesh e pëllumbash dhe thyes të të hollash duke ndenjor aty. Atëherë e punoi një frushkull konopësh dhe i dëboi nga Tempulli të gjithë së bashku me dele e me qe. Thyesve u derdhi të hollat dhe u rrëzoi tavolinat. Shitësve të pëllumbave u tha: “Hiqni këta prej këndej e mos e bëni shtë-pinë e Atit tim shtëpi tregtie!” Nxënësit e tij u kujtuan se është në Shkrim shenjt: “Zelli për Shtëpinë tënde më bren!”. Atëherë ndërhyne judenjtë dhe e pyetën: “Ç’shenjë na jep se guxon të veprosh kështu?” Jezusi u përgjigji: “Rrënojeni këtë Tempull e unë do ta rindërtoj për tri ditë!” “Dyzet e gjashtë vjet zgjati ndërtimi i këtij Tempulli – i përgjigjën judenjtë – e ti do ta ndërtosh për tri ditë?” Porse Jezusi foli për tempullin e trupit të vet. Kur u ringjall prej së vdekuri, atëherë u ra ndër mend nxënësve se këtë kishte dashur të thotë dhe i besuan Shkrimit shenjt dhe fjalës që tha Jezusi. Gjatë qëndrimit të Jezusit në Jerusalem në kohë të festës së Pashkëve, shumë besuan në emrin e tij, kur panë shenjat që bëri. Porse vetë Jezusi nuk kishte shumë besim në ta, sepse i njihte mirë të gjithë. Nuk kishte nevojë t’i dëshmonte kush për njeriun: sepse ai e dinte mirë çka njeriu ndryn përbrenda. *Gjn 2, 13-25*

Mesha Shenjte....

Mesha kremtohet çdo të dielë në orën 12:30 te Kisha: Our Lady of the Miraculous Medal, **739 BROWN'S LINE, Etobicoke**, M8W 3V7 (Browns Line & Evans Avenue) Phone (416) 255-2721. Kisha ndodhet menjehere mbrapa Slovenia Credit Union. Public transport: Brown's Line at Coules Court North Farside (15 m N) 123. Per me shume informacion shih faqen internet: www.ourladyofmm.com

Kalendari liturgjik...

9 Mars	Shen Françeska e Romës
10 Mars	40 Martiret e Sebastes
11 Mars	Shen Konstantini
12 Mars	Shen Maksimiliani
14 Mars	Shen Matilda

Udha e kryqit...

Te premten udha e kryqit kremtohet ne oren **7:45pm**.

Rregullat e Krezhmes... Në kohen e Krezhmes e Mërkurja e Përhime dhe të Premtet dhe të Shtunen e Madhe janë ditë njinesset dhe abstinencet. **Njinesa** është marrja e një vakti kryesor t'vetëm n'ditë por Kisha Katolike lejon me marr pak ushqim n'mjes e n'darkë, përveç vaktit kryesor. **Abstinenca** është mos-konsumimi i mishit apo i lëngjeve të mishit.

Kursi i gjuhes shqipe...

Çdo te diele ne oren 11 te ambientet e Kishes ne Browns Line vazhdon kursi i gjuhes shqipe per femijet (Ph. 416.503-4509)

Viti 2015, kalendar aktivitetesh...

Te shtunen **11 Prill** Easter Party; te dielen **9 Gusht** dita e piknikut; te dielen **6 Shtator** shtegtimi ne Midland Ontario; te shtunen **28 Nëntor** Party festa e Pavaresise; te shtunen **19 Dhjetor** Christmas Party.

Hakun e Kishes per vitin 2015

e kane dhene: **Leke Kapllaj, Sokol Ujka**

Deri tani kane dhene:

Aleks	Coku
Arben	Toma
Edi	Linadi
Leke	Kapllaj
Luk	Gjolaj
Marash	Martinaj
Martin	Pjetri
Nik	Biqi
Pjeter&Bep	Dreshaj
Prek	Lekaj
Preke	Gjonaj
Shpend	Pllumaj
Sokol	Ujka
Vladimir	Doda

Zoti ua shperblefte ne te mira e ua shtofte!

Per Hakun e Kishes: Vini re...

Sikur eshte caktuar me vendim te shumices se anetareve **Haku Vjetor i Kishes** eshte 500 dollare dhe mund te jipet ne cash, check ose me credit card (shih faqen website misioninenetereza.com Donate Now for Blessed Mother Teresa Mission), **ne nje shume te vetme ose pjese pjese** gjate vitit. **Ata te cilet per arsye te ndryshme jane ne veshtiresi te kontaktojne drejperdrejt me famullitarin.**

E ARDHMJA E SHPIRTIT



Nga Gjergj Meta

Spektrit të botimeve dhe gjinive të botuara sot në Shqipëri i mungon e ashtëquajtura *letërsi shpirtërore*. Ka klasikë të mendimit

shpirtëror të cilët njihen pak ose aspak nga lexuesi i mesëm shqiptar. Sigurisht është përkthyer ndonjë libër klasik, sikurse ai i *Rrëfimeve* të shën Agustinit i cili, edhe pse me problemet e veta të përkthimit, ka qarkulluar mjaft në duar të njerëzve. Aty-këtu nëpër komunitete fetare është botuar ndonjë klasik, si p.sh. Shën Bazili apo Tomë Akuini, Ignaci i Loyolës apo Tereza e Avilës, por që nuk kanë pasur një shtrirje aq sa duhet.

Çfarë janë botimet shpirtërore dhe pse janë të rëndësishme të jenë në një gjuhë të caktuar e sidomos në shqip? Së pari duhet të themi që kur flasim për jetë shpirtërore nuk flasim për një përmasë e cila i takon një religjioni apo një komuniteti fetar në mënyrë ekskluzive, pasi me shpirtin nuk merren vetëm fetë. Me shpirtin e njeriut merret edhe letërsia, edhe muzika, edhe filozofia, psikologjia apo sociologjia e secila prej tyre kontribuon në një farë mënyrë e në disa aspekte të asaj që ne e quajmë jetë shpirtërore. Një njeri mund të mos besojë në një religjion, por ai nuk mund të mos ketë një jetë shpirtërore. Këtu shkelim në një terren të pashtershëm i cili gjithsesi na tejkalon në çdo përpjekje tonën për ta kuptuar apo për ta rrethshkruar. Në rradhë të parë jeta shpirtërore është *jetë* e si e tillë është përvojë konkrete. Shpesh përvoja konkrete, duke qenë edhe mjaft personale, i shket mundësisë së “kafazit” në të cilin shpesh ne duam të fusim çdolloj përvojë. Kjo sepse njeriu në veteve, dhe kjo përmasë e tij në veçanti, është shumë e mistershme në kuptimin e gjërësisë, lartësisë dhe gjatësisë së shtrirjes, të mundësisë së kuptimit e të përjetimit. Thjesht po të nisemi nga përvojat tona më të thjeshta ne shpesh e kapim veten mat në gjëra që më parë nuk i kishim vërejtur në jetën tonë. *Shpesh edhe vetvetja na befason* e kjo na shtyn të mendojmë se sa të mistershëm jemi për veten tonë e jo më pastaj për të tjerët apo të tjerët për ne.

Janë disa përvoja jetësore, që mua më pëlqen t’i quaj “të fundme”, sepse qëndrojnë në fund, pra në themel të ekzistencës tonë, sikurse përvoja e *lindjes*, *vdekjes*, *miqësisë*, *dashurisë*, *dhimbjes*, *vuajtjes*, *tradhëtisë*, *besnikërisë*, *kuptimit të jetës*, *drejtimit të saj*, *plagët që na dhembnin përbrenda* etj. etj, të cilat kanë nevojë për një reflektim më shumë se sa thjesht konstatimi i tyre material apo klinik, apo një përpjekje për t’i shpjeguar nëpërmjet teorive psikonalitike. Pikërisht një qasje e tillë i mungon botimeve apo diskursit publik a komunitar në përgjithësi këtu në vendin tonë.

Jo vetëm nuk ka revista a botime të specializuara, por shpesh edhe kur ndeshesh me mundësinë e botimit të këtyre veprave menjëherë likujdohet si diçka që ka të bëjë me një komunitet fetar, ndërkohë që këto janë përvojat njerëzore më të rëndësishme, reflektimi rreth të cilave është reflektimi mbi vetë jetën.

Botimet apo nismat me karakter shpirtëror, dhe dua ta ritheksoj jo domosdoshmërisht fetar, paraqiten si një nevojë e madhe për realitetin tonë shqiptar. Mund të konstatojmë me lehtësi se si realiteti jonë është “helmuar” me konfliktualitet i cili mbetet ende protagonist i padiskutueshëm i jetës së përditshme, jo vetëm në marrëdhëniet ndërmjet grupeve kriminale (natyrshëm këtu), por fatkeqësisht edhe në marrëdhëniet ndërmjet individëve, ndërmjet botës akademike e politike, e sidomos në ndërtimin e shoqërisë dhe në qasjen-përplasje të vizioneve të ndryshme të jetës. Ka shumë helm, shumë urrjetje e shumë nervozizëm përreth. Jemi të gjithë fajtorë, sepse e ushqejmë së pari brenda nesh një gjë të tillë, nuk jemi të qetë e të kënaqur me vetveten më së pari. Këtë gjë ua përcjellim atyre që janë më të rinj, fëmijëve etj. Kështu prishim të tashmen e të ardhmen.

Një *përshpirtshmëri* (*spiritualitet*), fjala vjen,

e *dialogut* nevojitet urgjentisht që të hyjë në jetën tonë dhe sidomos në curriculum-et e formimit. Sa shumë të rinj apo të reja sot shikon që nuk dinë të strukturojnë kohën e tyre dhe “e vrasin” atë, të pavetëdijshëm se kështu po i vret ajo? Sa shumë të rinj apo të reja sot janë në kërkim të një kuptimi ekzistencial të jetës së tyre e të një kuptimi pse jeta e tyre duhet të zhvillohet e të jetohet në Shqipëri, apo thjesht pse duhet të jetohet? Sa shumë sot ambientet e specializuara nëpër spitale janë të paafta të ofrojnë një shërbim në *kurat palliative* apo në trajtimin njerëzor të një pacienti? Sa hapësira u ofrojmë sot çifteve të reja në krizë për t’i ndihmuar, jo që të bëjnë një divorc më të përsheptuar, por për të rithemeluar edhe njëherë dashurinë e tyre, që kur nisi dukej e përrjetshme?

Sot, jo vetëm duke marrë nga jashtë botime, çka do të isht diçka shumë e mirë, por mendoj se edhe ne dalëngadalë kemi mundësinë që të fillojmë të mendojmë për një spektër të tillë botimesh në Shqipëri e këta të shkojnë në duart e lexuesve, pasi do t’i ndihmojnë në reflektimin e tyre për një njeri më të shëndetshëm, për një shoqëri më të mire dhe një jetë më autentike. E ardhmja o ndërtohet duke u nisur nga shpirtërorja ose ajo do të jetë katastrofike.



EAR JESUS,

help me to spread Thy fragrance everywhere I go. Flood my soul with Thy spirit and love. Penetrate and possess my whole being so utterly that all my life may only be a radiance of Thine. Shine through me and be so in me that every soul I come in contact with may feel Thy presence in my soul. Let them look up and see no longer me but only Jesus. Stay with me and then I shall begin to shine as you shine, so to shine as to be a light to others.

Pope Francis



@Pontifex

Let us build our lives of faith on the rock who is Christ.

Giovanni Selmani
Sales Representative
Direct: 647.500.3875

Office: 905.565.9200
Fax: 905.565.6677
E-Mail: gioselmani@hotmail.com
www.rightathomerealty.com

7045 Edwards Blvd., Suite 401
Mississauga, ON L5S 1X2

Violeta Selmanaj, Broker
Tony Selmanaj, Sales Representative

Per Shitje, Blerje, Qera Shtëpi, Condo A Po
Biznese Lutemi Na Kontaktoni (Shume Vite
Eksperience Ne Toronto Dhe Rrethinat)

In House Mortgage Broker 25 Years
Experience Special Rates Through
Violeta and Tony Selmanaj For Fully
Qualified Applicants.
* Call for Details

Rates Subject To Change Without Notice and OAC

Direct (416) 553-5044
Office: (905) 279-8300
Email: vselmanaj@trebnet.com

ROYAL LEPAGE Realty Centre, Brokerage*

2150 Hurontario Street Mississauga, ON L5B 1M8

*Independently Owned & Operated. Not intended to solicit properties already listed for sale or buyers under contract.

Rocco C Lofranco LL.B
The Madison Centre
4950 Yonge Street Suite 600
Toronto ON M2N 6K1
416 223 8333
Toronto • Scarborough • Mississauga • Brampton

LOFRANCO CORRIERO
PERSONAL INJURY LAWYERS